# INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I KREDISË KONSUMATORE

## 1. Emri dhe detajet e kontaktit të bankës

| | |
|---|---|
| **Banka**<br>**Adresa**<br>**Numri i Telefonit**<br>**Adresa e postës elektronike**<br>**Adresa e *Web*-it** | Banka Amerikane e Investimeve<br>Rr. Kavajës, Nd.27, H.1, Nj.B.10, K.P.1001, Tiranë<br>+35542258755<br>customercare@abi.al<br>www.abi.al |

## 2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë

| | |
|---|---|
| **2.1-Lloji i Kredisë** | Kredi Konsumatore pa kolateral , e siguruar me dorëzani<br>Qëllimi i kësaj kredie është për të lehtësuar blerjen e të mirave konsumatore dhe personale. Klienti duhet të ketë burim të sigurtë të ardhurash ku përfshihen paga, të ardhurat nga biznesi, vetëpunësimi dhe të ardhurat nga kontratat e qirasë kur këto janë të deklaruara.<br>Banka financon 100% të nevojave të klientit brenda shumave të përcaktuara në këtë produkt. |
| **2.2-Vlera totale e kredisë dhe monedha** | Shuma : – Min. 25’000 Lek – Max. 2’000’000 Lek, ose ekuivalenti në monedhen Eur.<br>Monedha – LEK/ EUR |
| **2.3- Nëse është e aplikueshme Kredia në monedhë të ndryshme nga të ardhurat e konsumatorit** | a) Në monedhë të ndryshme nga të ardhurat ☐<br><br>b) Në të njëjtën monedhë me të ardhurat ☐ |
| **2.4- Nëse eshte e aplikueshme Vlera e kestit të kredisë, e shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat , mund të ndryshojë** | Ju do të merrni një njoftim në rastet ku, si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, kësti i kredisë _____________ (i shprehur në monedhën që klienti gjeneron të ardhurat), tejkalon vlerën ________ (shuma në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, e cila është pothuaj 20% më e lartë se kundërvlera e këstit që do të rezultonte nëse do të aplikohej kursi i këmbimit midis monedhës së kredisë dhe monedhës në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat me datën e nënshkrimit të kontratës).<br>Ju do të keni mundësinë të konvertoni monedhën e kredisë në (monedhën në të cilën gjeneroni të ardhurat), nëse plotësohen kushtet e bankes. |
| **Shembull:** | (see table below) |

| Skenari | Kursi I kembimit | Vlera e kestit e shprehur ne monedhen e kredise (a) | Kundervlera e kestit ne monedhen ne te cilen gjenerohen te ardhurat (b) | Te ardhurat (mesatarja mujore te 3 viteve te fundit) ne monedhen ne te cilen ato gjenerohen © | Raporti I vleres se kestit ndaj te ardhurave (d)= (b)/( c ) |
|---|---|---|---|---|---|
| Kursi I kembimit nuk ndryshon | 125 | 102 | 12,750 | 100,000 | 12.8% |
| Nencmim I kursit te kembimit me 5 % | 131.25 | 102 | 13,388 | 100,000 | 13.4% |
| Nencmim I kursit te kembimit me 20 % | 150 | 102 | 15,300 | 100,000 | 15.3% |

| | |
|---|---|
| **2.5-Kushtet që rregullojnë terheqjen e fondeve.** | Si kusht për lëvrimin e kredisë, Kredimarrësi do të hapë një llogari rrjedhëse pranë Abi Bank, në të cilën Banka do të bëjë disbursimin e fondeve dhe nëpërmjet të cilës do të bëhet dhe ripagimi i kredisë. Kredia do të disbursohet me kërkesë të kredimarrësit në një shumë të vetme me kusht që klienti të ketë përmbushur kërkesat e bankës para lëvrimit të fondeve.<br>Tërheqja e kredisë do të bëhet në një nga mënyrat: a) me anë të tërheqjes në të holla;-b) me anë të tërheqjes me mjete elektronike;- c) me anë të një ceku të lëshuar nga vetë klienti mbi bankën;-d) me anë të urdhër-pagesës së dhënë me shkrim në favor të të tretëve. |
| **2.6-Kohëzgjatja e kontratës së kredisë** | 6 muaj deri në 7 vjet |
| **2.7-Këstet dhe kur është e mundur mënyra së si do të shlyhen këstet.** | Kredia paguhet në këste të barabarta mujore. Numri total i késteve varet nga afati i maturimit te kredise.<br>Kësti = Shuma e kryegjësë + Shumën e interesit e shpërndarë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kredisë, sipas planit të ripagimit. |

E rëndësishme: Vlerat e sipërpërmendura nuk jenë përfundimtare dhe mund të mos përputhen me vlerat finale te kontrates se huamarrjes. Kushtet janë subjekt ndryshimi në varësi të të ardhurave, historikut në sistemin bankar,etj., elemente këto që do të vlerësohen gjatë aplikimit për kredi, dhe për të cilat klienti do të informohet në vazhdim të procesit.

| | |
|---|---|
| | Ne momentin e disbursimit te kredise, klientit do t'i vihet ne dispozicion plani i amortizimit të kredisë ne te cilin percaktohet shuma e kestit te kredise, numri i kesteve dhe datat e pagesave te tyre. . |
| **2.8-Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar** | Shuma totale që do të paguhet nga klienti në fund të maturimit të kredisë do të jetë:<br>Vlera e akorduar e kredisë + interesat deri në fund të periudhës + të gjitha kostot e tjera që lidhen me marrjen e kredisë. |
| **2.9-Garanci/siguri të nevojshme** | Banka kërkon bashkëhuamarrës apo garantor / dorëzanes për këtë kredi. Nuk kërkohet garanci / kolateral hipotekor.<br>Dorëzanësit garantojnë pa rezerva Bankën së do të përgjigjen me të gjithë pasurinë e tyre, për përmbushjen e detyrimeve totale që rrjedhin nga kjo kontratë Kredie dhe ndryshimet e saj. |

## 3. Kostoja e kredisë

| | |
|---|---|
| **3.1-Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë.** | Kredia jepet në EUR, LEK<br>Norma e interesit është:<br>**LEK:** Bono Thesari (12 mujore) + 7.5%, min 9%<br>**EUR**: Euribor 12 mujor + 8%, min 8%<br>Indeksi i kredise rishikohet nje here ne vit, ne nje date pagese kesti sipas kushteve te dakortesuara ne kontraten e kredise |
| **3.2-Norma efektive e interesit (NEI)** | Norma efektive e interesit (NEI) përcakton koston totale që klienti do të përballojë për kredinë e marrë, me kushtet që: kredia do të shlyhet për periudhën e rënë dakort, palët i përmbahen kushteve të përcaktuara në kontratë, interesi dhe shpenzimet e tjera mbeten të pandryshuara deri në fund të maturimit të kredisë. Norma efektive (NEI) shprehet si përqindje vjetore e vlerës së kredisë dhe përbëhet nga tërësia e shpenzimeve të klientit për marrjen e saj, duke përfshirë interesin e aplikuar, komisionin e disbursimit të kredisë dhe primet e sigurimit të jetës të detyrueshme për tu paguar nga klienti. Për qëllime të llogaritjes se NEI totali i kostos se kredisë nuk përfshin shpenzime që nuk njihen në datën e llogaritjes se NEI, shpenzime të pagueshme nga kredimarrësi të detyrimeve për moszbatimin e kushteve të parashikuara në kontratë, kostot e pagueshme nga kredimarrësi lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tjerë (për shembull, tarifat noteriale, tarifat e Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të percaktuara sipas akteve përkatëse). Klienti do të informohet për normën efektive të interesit në momentin e aplikimit të kredisë : NEI do të jetë pjesë e kontratës së kredisë dhe në disbursimin e fondeve klienti do të pajiset me planin e amortizimit të kredisë |

**Perllogaritje e kestit te kredise me afat**

**Monedha** ALL

| Te dhenat | |
|---|---|
| Vlera e Kredise | 1,500,000 |
| Nomra e Interesit | 9.00% |
| Afati i Kredise | 7 |
| Primi I Sigurimit te Prones | - |
| Primi I Sigurimit te Jetes | 2,000 |
| Data e Fillimit te Kredise | 14-Jul-22 |
| Pagesa te tjera opsionale | 0.00 |
| Komision Disbursimi | 1.00% |
| Komision llogarie | 0.00 |

| Permbledhje | |
|---|---|
| Kesti i kredise | 24,134 |
| Numri I pagesave | 84 |
| Shuma e Primit te Sig te Prones | - |
| Shuma e Primit te Sig te Jetes | 14,000 |
| Norma Periodike | 0.75% |
| Data e Maturimit | 14-Jul-29 |
| Intersi Total | 527,224 |
| Shuma e komisionit te llog | - |
| **NEI** | **9.965%** |

| No | Data e Pageses | Vlera ne Fillim | Kom mujor | Sig I Prones | Sig I Jetes | Kesti | Pagesa totale | Kryegjeja | Interesi | Vlera ne Fund |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 14/07/2022 | | | | | | - 1,500,000.00 | | | |
| | 14/07/2022 | | | | | | 17,000.00 | | | |
| 1 | 14/08/2022 | 1,500,000.00 | - | - | - | 24,133.62 | 24,133.62 | 12,883.62 | 11,250.00 | 1,487,116.38 |
| 2 | 14/09/2022 | 1,487,116.38 | - | - | - | 24,133.62 | 24,133.62 | 12,980.24 | 11,153.37 | 1,474,136.14 |
| 3 | 14/10/2022 | 1,474,136.14 | - | - | - | 24,133.62 | 24,133.62 | 13,077.60 | 11,056.02 | 1,461,058.54 |
| 4 | 14/11/2022 | 1,461,058.54 | - | - | - | 24,133.62 | 24,133.62 | 13,175.68 | 10,957.94 | 1,447,882.86 |
| 5 | 14/12/2022 | 1,447,882.86 | - | - | - | 24,133.62 | 24,133.62 | 13,274.50 | 10,859.12 | 1,434,608.37 |
| 6 | 14/01/2023 | 1,434,608.37 | - | - | - | 24,133.62 | 24,133.62 | 13,374.05 | 10,759.56 | 1,421,234.31 |
| 7 | 14/02/2023 | 1,421,234.31 | - | - | - | 24,133.62 | 24,133.62 | 13,474.36 | 10,659.26 | 1,407,759.95 |
| 8 | 14/03/2023 | 1,407,759.95 | - | - | - | 24,133.62 | 24,133.62 | 13,575.42 | 10,558.20 | 1,394,184.54 |
| 9 | 14/04/2023 | 1,394,184.54 | - | - | - | 24,133.62 | 24,133.62 | 13,677.23 | 10,456.38 | 1,380,507.30 |
| 10 | 14/05/2023 | 1,380,507.30 | - | - | - | 24,133.62 | 24,133.62 | 13,779.81 | 10,353.80 | 1,366,727.49 |
| 11 | 14/06/2023 | 1,366,727.49 | - | - | - | 24,133.62 | 24,133.62 | 13,883.16 | 10,250.46 | 1,352,844.33 |
| 12 | 14/07/2023 | 1,352,844.33 | - | - | 2,000 | 24,133.62 | 26,133.62 | 13,987.28 | 10,146.33 | 1,338,857.04 |

| | |
|---|---|
| **3.3- Kontratat e sigurimit të kredisë** | Kredia konsumatore shoqerohet me sigurim jete. |

E rëndësishme: Vlerat e sipërpërmendura nuk jenë përfundimtare dhe mund të mos përputhen me vlerat finale te kontrates se huamarrjes. Kushtet janë subjekt ndryshimi në varësi të të ardhurave, historikut në sistemin bankar,etj., elemente këto që do të vlerësohen gjatë aplikimit për kredi, dhe për të cilat klienti do të informohet në vazhdim të procesit.

| | |
|---|---|
| **3.4- Kosto të tjera të lidhura me kredinë** | Mbajtja e një llogarie është e nevojshme për regjistrimin e transaksioneve të kredisë. Kjo llogari i nenshtrohet kushteve te punes te Bankes ne fuqi, persa i perket termave komisioneve dhe normes se interesit te aplikuar. |
| **3.5- Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë.** | **1.** Komision disbursimi<br>-0 % për blerje nga banka të tjera.<br>-1% mbi shumën e kredisë, për klientët pagamarrës min 3,000 Lek / 20 Eur.<br>-2%, mbi shumën e kredisë, për klientët pagamarrës min 3,000 Lek / 20 Eur.<br>**2.** Primi i policës së sigurimit të jetës ~ 0.07%-4.5% e shumës së kredisë (Varion nga shuma e kredisë, mosha dhe gjinia e aplikantit)<br>Kostot e mësipërme klasifikohen si kosto pas miratimit të kredisë. Këto shpenzime janë të pashmangëshme dhe të detyrueshme para disbursimit të kredisë. Shpenzimet e komisionit të disbursimit mbahen vetëm një herë, ndërsa primet e policave të sigurimit të jetës përsëriten cdo vit. |
| **3.6- Ndonjë kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë.** | Komision për ndryshime në kontratën e kredisë është 0 %. |
| **3.7-Penalitet të tjera** | - Kur gjatë disbursimit Banka konstaton së Kredimarrësi ka dalë jashtë kushteve të parashikuara në Kontratën e kredisë nënshkruar nga palët, Banka ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate, që do të shoqërohet me kthimin e shumave të përdorura deri në atë moment dhe interesin përkatës.<br>-Në rast së Banka zbulon që kredia nuk është përdorur për qëllimin e akorduar, atëherë ajo ka të drejtën që të kërkojë menjëherë ri-kthimin e kredisë dhe të interesave të akumuluara.<br>-Në rast të mospagimit të interesit, Banka ka të drejtë të aplikojë një penalitet prej 30 (tridhjetë)%, në vit, i llogaritur mbi detyrimin e Këstit të rradhës së pa paguar (kryegjë + interes) për periudhën në të cilën ai është në vonesë në bazë të kushteve të kësaj kontrate. Penaliteti do të llogaritet bazuar në ditë kalendarike, ku cdo muaj do të llogaritet në 30 ditë kalendarike. Totali i Penalitet +kamatvonese nuk do te tejkalojne me shume se 30% te shumes se detyrimit te papaguar.<br>Përllogaritja e penalitetit shembull : kësti i radhës është 30,000 Lekë, Ditë në vonesë 5 ditë. Penaliteti për tu paguar = 30,000 Lekë x 30% x 5 ditë (në vonesë) / 360 ditë = 125 Lekë.<br>Totali i penalitet + kamatvonese nuk do te tejkalojne me shume se 30% te shumes se detyrimit te papaguar. |
| **3.7-E drejta per tu pajisur me kopje te kontrates** | Klienti ka te drejte te per tu pajisur, me kerkesen e tij, pa pagese me nje kopje paraprake te kontrates se kredise. |

**4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore**

| | |
|---|---|
| **4.1-E drejta për t'u tërhequr** | Po ☐ Jo ☐<br>Huamarrësi ka të drejtën të tërhiqet nga kontrata e kredisë brenda një periudhë 14 (katërmbëdhjetë) ditore nga momenti i lidhjes së saj, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Bankës. Në rastet kur shuma e kredisë është disbursuar në llogarinë e klientit dhe ky i fundit ushtron të drejtën për tu tërhequr nga Kontrata e Kredisë, atëherë klienti pranon dhe merr përsipër të shlyejë kryegjënë dhe interesat per ditet perkatese si dhe shpenzime të tjera të mundshme të bankës të krijuara me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj shume, mbi bazën e konfirmimit nga ana e Bankes te vlerës per t'u kthyer. Nëse kredimarrësi tërhiqet nga kontrata e kredisë, gjithashtu edhe bashkëkredimarrësi ose dorëzanësi, tërhiqen nga kontrata e kredisë ose tërheqin garancinë/të e vendosura prej tij për ekzekutimin e kontratës. |
| **4.2-Shlyerja e kredisë perpara afatit të maturimit** | Kredimarrësi ka te drejte te kryeje ne cdo kohe para afatit te maturimit shlyerjen e pjesshme ose te plote te kredise. |
| **4.3-Banka ka te drejtën e kompesimit, në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit** | Banka mund te pranoje shlyerje të pjesshme ose të plotë të Kredisë, përpara afatit të maturimit, me kusht që kredimarrësi të njoftojë Bankën paraprakisht për shumën që kërkon të shlyejë 14 (katermbedhjete) ditë pune përpara si dhe të paguajë të gjitha interesat e rradhës.<br>Në rast së ndodh shlyerja e pjesshme ose e plotë e kredisë përpara afatit të maturimit, Banka nuk do të aplikojë komision parapagimi. |
| **4.4-Informimi në rast refuzimi të kredisë** | Banka informon menjëherë konsumatorin në rast të refuzimit të kredisë duke i vënë në dispozicion arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim. |
| **4.5- E drejta per tu pajisur me kopje te kontrates** | Klienti ka te drejte te per tu pajisur, me kerkesen e tij, pa pagese me nje kopje paraprake te kontrates se kartes se debitit. |
| **4.6-Mënyra e njoftimit si dhe mënyra e marrjes e pëlqimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve te** | Të gjithë njoftimet, kërkesat apo komunikimet midis palëve do të behen me shkrim, nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit ose mesazheve telefonike si dhe nëpërmjet afishimit të njoftimeve në ambientet e bankës, në faqen zyrtare të internetit ose në mjetet e komunikimit masiv dhe do të konsiderohen të njoftuara nëse dërgohen në adresat e palëve të deklaruara në Bankë. |

E rëndësishme: Vlerat e sipërpërmendura nuk janë përfundimtare dhe mund të mos përputhen me vlerat finale te kontrates se huamarrjes. Kushtet janë subjekt ndryshimi në varësi të të ardhurave, historikut në sistemin bankar,etj., elemente këto që do të vlerësohen gjatë aplikimit për kredi, dhe për të cilat klienti do të informohet në vazhdim të procesit.

| | |
|---|---|
| **cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës** | Banka duhet të njoftojë me shkrim, nëpermjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit ose mesazheve telefonike, kredimarrësin për ndryshimet në kushtet e kontratës 30 (tridhjetë) ditë përpara aplikimit të ndryshimeve. Kredimarrësi deklaron dhe pranon që të gjithë llojet e njoftimeve të bëra në adresat e deklaruara do të konsiderohen si të marra nga ai. Kredimarrësi mund t'i paraqesë Bankës reklamimet e tij, për sa njoftohet, brenda një afati prej 15 ditësh kalanderike.<br>Kredimarrësi është i detyruar që për cdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Bankën brenda 15 ditëve kalendarike për këtë ndryshim. Përsa kohë që ai nuk ka njoftuar adresën e re, Kredimarrësi nuk ka të drejte të kundërshtoje njoftimet e bëra në adresën e mëparshme |
| **4.7-Skema e brendshme e ankimimit të konsumatorit kundrejt Bankës.** | -Ankesë me shkrim pranë cdo degë drejtuar Zyrës së Kujdesit për klientin, Rr. Kavajës, Nd. 27/1, K.P 1001, Tiranë<br>-Vizitë pranë cdo dege ose agjensie .<br>-Nepërmjet telefonit (Tel: 042258755-60)<br>-Nepërmjet adresës elektronike Email: customercare@abi.al |
| **4.8-Periudha kohore gjatë së cilës Banka ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor.** | Ky informacion është i vlefshëm për një periudhë 7 ditore duke filluar prej nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti.<br>Gjatë kësaj periudhë kushtet e përcaktuara janë të pandyshueshme. |

5. **Shëmbull ilustrues për rrezikun e kursit të këmbimit për kredinë në monedhë të ndryshme nga ajo e gjenerimit të të ardhurave**

| | |
|---|---|
| **5.1-Tekst sqarues për konsumatorin** | Kredidhënia në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerohen të ardhurat për konsumatorin që nuk është I mbrojtur nga rreziku I kursit të këmbimit shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme. Për shëmbull një nëncmim I fortë I kursit të këmbimit do të shkaktonte vështirësi në aftësinë e konsumatorit për të shlyer kredinë. Këto vështirësi mund të conin në dështimin e konsumatorit për të shlyer kredinë; në kthimin e kredisë në statusin "me problem" dhe mund të përfundonin në fillimin e procedurave për egzekutimin e detyrimit nga ana e bankës.<br>Ky aneks përmban një shëmbull me natyre ilustruese dhe informuese dhe nuk përfaqëson një pritshmëri apo angazhim ligjor nga kredidhënësi apo kredimarrësi.<br>Konsumatori që aplikon për kredi në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjeneron të ardhurat, nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti vërteton se : 1) e ka marrë këtë document nga banka përpara lidhjes së kontratës së kredisë: 2) e ka kuptuar shëmbullin dhe efektet e mundshme nga lëvizjet në kursin e këmbimit ; 3) është I bindur që mund të përballojë rreziqet që shoqërojnë kredinë.<br>Dokumenti I nënshkruar është pjesë e analizës që bën banka për dhënien e kredisë të konsumatorit por dokumenti I nënshkruar nuk e detyron bankën për dhënien e kredisë dhe as nuk e redukton përgjegjesinë që ka banka për të kryer analizën e saj të plotë, për qëndrueshmërinë financiare të aplikuesit për kredi. |
| **5.2-Të dhënat për kredinë në monedhë të ndryshme nga monedha e gjenerimit të të ardhurave** | **Shembull:**<br>Kredimarrësi:____________________<br><br>Kredidhënësi: Banka Amerikane e Investimeve<br>Lloji kredisë: Konsumatore<br>Kohëzgjatja e kredisë: 60 muaj<br>Vlera e kredisë: 5.000 Eur<br>Njesia monetare: Eur<br>Kursi I këmbimit në datën e vlerësimit të planit ilustrues: 125<br>Kundërvlera e kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat: 625.000 Leke<br>Kesti I kredise: 102 Eur<br>Norma efektive e interesit: 9.55%<br>Indeksi orientues / normë reference :Euribor 12M<br>Marzhi: 8.0%<br>Të ardhurat mujore (bruto / Neto) të huamarrësit në monedhen në të cilën gjeneron të ardhurat (mesatare e 3 viteve të fundit): 100.000 Leke |

______________/_____/_______ (Qyteti, dd, mm, vvvv)

_________________________________ (Klienti: Emër, Mbiemër, Firmë)

E rëndësishme: Vlerat e sipërpërmendura nuk jenë përfundimtare dhe mund të mos përputhen me vlerat finale te kontrates se huamarrjes. Kushtet janë subjekt ndryshimi në varësi të të ardhurave, historikut në sistemin bankar,etj., elemente këto që do të vlerësohen gjatë aplikimit për kredi, dhe për të cilat klienti do të informohet në vazhdim të procesit.